



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 15230 Prot.

Lezhë, më 02.10. 2023

VENDIM

Nr. 41, Datë 28. 09. 2023

**PËR
MIRATIMIN E PLANIT TEMATIK VJETOR TË KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË
PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; neni 8, neni 53, neni 54 dhe neni 70, si dhe në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë e miratuar me Vendimin Nr. 54, datë 28.04.2020 të Këshillit Bashkiak, i ndryshuar, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1-Të miratojë Planin tematik vjetor të Këshillit të Bashkisë Lezhë për vitin 2024, sipas muajve:

➤ **JANAR**

- ❖ Mbledhja e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor 2024 dhe tre vitet e ardhshme buxhetore 2025-2027
- ❖ Analize për zbatimin/rishikimin e Planit Social të Bashkisë Lezhë
- ❖ Informacion nga OSHEE për punën e bërë dhe masat e marra për furnizimin me energji elektrike
- ❖ Fillimi i procesit për krijimin e sekretariatit të Këshillit
- ❖ Këshilli informohet dhe diskuton planin vjetor të prokurimit për të gjitha projektet e reja dhe ato në vazhdim të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

➤ **SHKURT**

- ❖ Mbledhja e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në vijën bregdetare të Bashkisë Lezhë
- ❖ Analizë mbi punën dhe veprimtarinë e SHA Ujësjetës Kanalizime Lezhë
- ❖ Trajnim i Këshillit mbi zbatimin e Rregullores së përgjithshme, për Kodin e Etikës dhe për Strukturat Komunitare
- ❖ Këshilli informohet dhe diskuton raportin e katër mujorit të tretë, dhe njëkohësisht i dymbëdhjetë mujorit, mbi performancën e produkteve për secilin program të buxhetit vjetor të vitit paraardhës të Bashkisë të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, përfshirë raportin mbi të ardhurat e paarkëtuara
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike

- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

➤ **MARS**

- ❖ Mbledhja e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Raportim i Auditit të Brendshëm mbi kontrollin dhe problemet e shfaqura gjatë vitit 2023 në administrimin e fondeve në Bashki
- ❖ Analiza dhe informim për çështje të tatim -taksave të Bashkisë Lezhë.
- ❖ Analize/informim për bujqesinë dhe çështjet e lidhura me të nga Bashkia Lezhë
- ❖ Anketimi vjetor për vlerësimin nga komuniteti të punës dhe rezultateve të Këshillit (Familje, Biznese, të rinj)
- ❖ Hartimi i raportit të veprimtarisë vjetore të KB dhe transparencën në procesin e vendimmarrjes së Këshillit
- ❖ Takimi vjetor i Këshillit me qytetaret për prezantimin e raportit të veprimtarisë vjetore (Ilogaridhenja) 1 komuniteti +1 Biznesi + 1 OJF
- ❖ Pjesëmarrje në festa e ngjarje vendore
- ❖ Ceremoni perkujtimore / dhënie tituj nderi etj, aktivitete me rastin e 7-8 Marsit në bashkëpunim me DRAP/ZVAP dhe Bashkinë Lezhë
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

➤ **PRILL**

- ❖ Mbledhja e Këshillit dhe të Komisioneve të Përhershme
- ❖ Analizë mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve të investimeve në territorin e Bashkisë Lezhë
- ❖ Informacion mbi funksionimin dhe veprimtarinë e punës së institucioneve vartëse
- ❖ Informacion mbi punën e bërë për përmirësimin e treguesve të shërbimit veteriner
- ❖ Analize për menaxhimin e mbetjeve dhe ofrimin e shërbimeve nga Bashkia Lezhë
- ❖ Informacion për problemet mbi pronësinë dhe puna e administratës përkatëse dhe ASHK-së
- ❖ Informacion nga Bashkia në lidhje me aktivitetet mjedisore në kuadër të Dites Boterore të tokës
- ❖ Organizimi i dëgjësive me publikun lidhur me tavanet e buxhetit për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

➤ **MAJ**

- ❖ Mbledhja e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Analizë mbi realizimin e treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve për tremujorin e parë 2024
- ❖ Informacion për masat e marra për një sezon turistik sa më të suksesshëm.
- ❖ Analizë mbi punën e bërë nga sipërmarrjet dhe efekti i përdorimit të fondeve në këtë sektor
- ❖ Monitorimi në terren i strukturave komunitare (2 vizita në terren)
- ❖ Këshillit informohet dhe diskuton raportin e parë katër-mujor mbi performancën e produkteve për secilin program të buxhetit vjetor të vitit korent të Bashkisë të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, përfshirë raportin mbi të ardhurat e paarkëtuara
- ❖ Këshillit merr nga Kryetari i Bashkisë raportin e konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit vjetor të vitit paraardhës të Bashkisë
- ❖ Trajnim të Këshillit mbi Planin Vjetor dhe Buxhetimin si dhe zbatimin e Rregullores Ankesave, Kerkesave, nismave dhe peticioneve
- ❖ Monitorim/Mirmbajtje e rregjistrimit të Ankesave, kërkesave dhe vërejtjeve
- ❖ Vizite Studimore të Këshillit brenda Shqipërisë në dy njësi vendore (Gjirokastrë, Berat)

- ❖ Këshilli përmyll dëgjesat me publikun lidhur me tavanet e buxhetit për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

➤ QERSHOR

- ❖ Mbledhja e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Analizë mbi masat e marra për kontrollin mbi territorin
- ❖ Analizë mbi punën që është bërë nga administrata e bashkisë për zbatimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak
- ❖ Informacion mbi situatën për rendin, qetësinë dhe masat e marra në këtë drejtim
- ❖ Bashkia dergon ne Këshill per miratim projektin e parë të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm PBA, duke marrë parasysh edhe mendimet e Ministrisë së Financave
- ❖ Këshilli zhvillon seancave të konsultimeve me publikun mbi rishikimin e buxhetit
- ❖ Informacion mbi nivelin dhe standartin e shërbimit parësor dhe masat e marra për parandalimin e sëmundjeve infektive për sezonin veror
- ❖ Trajnime të Sekretarit të Keshillit -zbatimi i rregulloreve
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

➤ KORRIK

- ❖ Mbledhja e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Analizë mbi efektivitetin e përdorimit të aseteve në administrim të Bashkisë Lezhë
- ❖ Analize e çeshtjeve të arsimit nga Bashkia Lezhe si dhe dhe objektivat per pergatitjen e vitit të ri mesimor
- ❖ Analize / informim i bashkise Lezhe mbi çeshtje të mbrojtjes civile (zjarre, permbytje, termete)
- ❖ Monitorimi i zbatimit të buxhetit 4-mujor
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

➤ GUSHT

- ❖ Mbledhja e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Analizë mbi realizimin e treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve për 6-mujorin e parë 2024
- ❖ Informacion mbi treguesit mjedisorë dhe masat e marra për përmirësimin e tyre
- ❖ Informacion mbi problemet urbanistike dhe studimet për të ardhmen në qytet dhe në fshat
- ❖ Ceremoni dhenie titull nderi , Organizimi dites së shtegtarit etj
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

➤ SHTATOR

- ❖ Mbledhja e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Analizë mbi punën e bërë dhe problemet e shfaqura në sektorin e shërbimeve publike
- ❖ Informacion per mbarëvajtjen e kredive te buta për strehim.
- ❖ Informacion mbi mbështetjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe nxitja e punësimit.

- ❖ Analize/ Informimi per çeshtje të rrugeve perfshirë dhe rruget rurale
- ❖ Vizite Studimore jashtë Shqiperise (Spanje ose Hollande)
- ❖ Konsultim per iniciativa qytetare (dhenie marrje me qera/ plane/norma sektoriale)
- ❖ Hartimi i Planit Vjetor te Punes se KB Lezhe
- ❖ Hartimi i Buxhetit te KB Lezhe
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

➤ **TETOR**

- ❖ Mbledhja e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Analizë mbi punën e bërë për përmirësimin e treguesve të shërbimeve në sektorin e pritjes së qytetarëve
- ❖ Informacion mbi me mbarevajtjen e sezonit turistik, realizimin e treguesve në fushën e turizmit dhe propagandimit të vlerave muzeale
- ❖ Këshilli reflekton propozimet e dokumentuara nga konsultimet me publikun dhe në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë bën ndryshimet përkatëse në dokumentin e dytë të programit buxhetor afatmesëm
- ❖ Këshillit informohet dhe diskuton raportin e dytë katër-mujor, dhe njëkohësisht tetëmujor, mbi performancën e produkteve për secilin program të buxhetit vjetor të vitit korent të Bashkisë të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, përfshirë raportin mbi të ardhurat e paarkëtuara
- ❖ Monitorimi i zbatimit të buxhetit 8-mujor
- ❖ Trajnim të Sekretarit dhe Këshillit mbi zbatimin e Rregullores së K. Bashkiak për konsultimet me publikun
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

➤ **NËNTOR**

- ❖ Mbledhja e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Analizë mbi realizimin e treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve për 9-mujorin 2020
- ❖ Këshilli merr nga Kryetari i Bashkisë projekt dokumentin përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm PBA dhe të projekt-buxhetit vjetor
- ❖ Këshilli zhvillon seanca të konsultimeve me publikun për projekt dokumentin e programit buxhetor afatmesëm dhe të projekt-buxhetit vjetor përfshirë Planin Vjetor
- ❖ Zhvillimi i dëgjësive publike dhe konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit, lidhur me nivelin e taksave, tarifave, dhe prioriteteve të investimeve për tre vitet e ardhshme. (10 NjA+ komuniteti biznesit+OJF/grupe interesi),
- ❖ Ceremoni dhënie titull nderi me rastin e festave të Nëntorit
- ❖ Pjesëmarrje në festa e ngjarje vendore / Përfaqësim institucional i Këshillit
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

➤ **DHJETOR**


- ❖ Mbledhja e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i Paketës Fiskale
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i trajtimit me bursë të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2023-2024

- ❖ Informacion në KB nga Keshilli Vendor Rinor në kuader të Dites Kombetare të Rinise mbi masat e marra për rininë.
 - ❖ Monitorimi ne terren i strukturave komunitare
 - ❖ Vizite studimore jashte vendi Kroaci
 - ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
 - ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
 - ❖ Të ndryshme
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryesia e Këshillit të Bashkisë Lezhë
 3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
NDUE LULI



Prot 15230/
DT 9.10.23



KB.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 787/12 Prot.

Lezhë, më 09.10.2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.41, datë 28.09.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë, "Për miratimin e planit tematik vjetor të Këshillit të Bashkisë Lezhë për vitin 2024".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

